



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0010

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP-së në përbërjen nga Vjosa Gradinaj-Mexhuani-kryetare, duke vendosur sipas ankesës së OE “Europrint Group Sh.P.K.” kundër Njoftimit për dhënie të një kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material te ndryshëm zyrtar” me nr. të prokurimit: "214-23-11396-1-2-1" inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme, më 13/03/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e “Europrint Group Sh.P.K.” me nr. 2024/10, e datës 04.01.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me material te ndryshëm zyrtar” me nr. të prokurimit: "214-23-11396-1-2-1" inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme.
2. Mbetët në fuqi, njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues –Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën 1 të dispozitivit.
3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me 02.11.2023, Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues [AK] ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me material te ndryshëm zyrtar” me nr. të prokurimit "214-23-11396-1-2-1". Ndërsa me datën

19.12.2023, AK ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "Ndërmarrja Tregtare Grafike Blendi O.P"

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 120,000.00 €

Me 22.12.2023, OE "Europrint Group Sh.P.K." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 28.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Europrint Group Sh.P.K." e cila është protokuluar me nr. 10/24 .

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

1. *Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar si në vijim:*

Pretendimi i parë (I): Autoriteti kontraktues gjate procesdurës së rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,6 7,59 dhe 60 duke cituar mes tjerash se "Me datën 04.12.2023 ora 13:00 është bërë dalje nga depoja për mostrat për tenderin "Furnizim me material të ndryshëm zyrtar te MPB" dhe te gjitha këto janë numëruar dhe janë vërtetuar nga zyrtari i depos për kontrollin e stokut dhe faturimin ne përgatitjen e mostrave dhe verifikimin e tyre janë tre zyrtar qe kane krye përgatitjen edhe markimin e mostrave dhe te gjithat mostrat janë nda dhe paketu ne dy pako njëra për MPB kurse tjera për menaxherin e kontratave me blerës i cili e përgatitë mallin sipas mostrave te dërguara. Kështu që është 100% sigurt që mostrat e kërkuar nga dosja e tenderit janë paketu dhe dërgu në tërësi artikulli i konstatuar numër 26 ka qenë i markuar dhe paketu ne dy ngjyra për mos te këtë keqkuptim për ngjyrat në rastin e porosisë nga autoriteti. Kurse sa i përket printimit te logos ne mostra nuk ka qenë kërkesë në dokumentin e tenderit sepse ne nuk kemi marre kurrfarë dizajni nga Autoriteti Kontraktues dhe kërkesë që atij dizajni te printohet ne mostra. Bazuar në përshkrimin e mësipërm dhe dispozitat ligjore te lartcekura te LPP-se dhe Ligjeve tjera ne fuqi konstatojmë se AK- Ministria e Punëve të Brendshme është duke bërë shkelje dhe vlerësim jo te drejtë dhe te gabuar te ligjeve te lartcekura duke minimizuar konkurrencën duke krijuar monopol ne tregu dhe duke shkelur parimet e LPP-se qe janë transparenca dhe konkurrenca. Kërkojmë nga OSHP-ja me qe sipas dispozitave ligjore te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me

ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, te aprovoj kërkesën për rishqyrtim tonë si të Bazuar dhe të kthejë lëndën prapë në Rivlerësim si dhe te merren masa ndaj zyrtareve te prokurimit te cilët me qëllim e kanë larguar mostrën vetëm për të na eliminuar neve si OE dhe te shpallim fitues Operatorin ekonomik te cilët ja kanë përgatitur procedurën nga fillimi. Bashkangjitur gjeni edhe dudat doganore për posedim te kimikave si dhe flete dorëzimin e mallit dhe flete pranimin e mallit nga punëtore i prokurimit ne kompaninë tone si dhe flete dorëzimin e mallit për MPB.”

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Nenin 1, 6, 7, 59, 60, të LPP-së. Bazuar në të gjitha të dhënat e shënuara me larte në këtë Ankesë, dëshmitë e bashkangjitura kësaj ankese dhe dokumentacionin e këtij aktiviteti të prokurimit, kërkojmë nga Paneli Shqyrtuese i OSHP-së, që Ankesa jonë të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të urdhërohet AK– Ministria e Punëve të Brendshme te kthej lenden ne rivlerësim dhe njëherësh te i kthej te gjitha mostrat se bashku me mostrën qe e kane larguar me qellim dhe te merren masa ndaj zyrës e prokurimit ne baze te nenit 90 te ju revokohet certifikata e prokurimit për shkeljet qe i kane bere.”

2.Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim të Ankuesit (me të dhënat si më lartë):

“Ministria Punëve të Brendshme, pas pranimit te Kërkesës për rishqyrtim ka shqyrtuar vlefshmërinë e gjitha pretendimeve të palës ankimore “Europrinty Group” Shpk, Prishtinë. Pas analizës se pretendimeve të cekura në Kërkesën për rishqyrtim, ka ardhur në konstatim se nuk kemi te bëjmë me shkelje të Neneve 1, 6, 7, 59 dhe 60-të LPP-së. Deklarimi i ankuesit se vlerësimi AK, është jo i drejtë sepse eliminimi i tij është në kundërshtim em dispozitat e cituara si më sipër, së është i pa bazuar sepse AK përkundrazi e ka shpallur fitues tenderuesin i cili ka dorëzuar tender të përgjegjshëm, ju jeni eliminuar, pasi qe nuk keni dorëzuar tender te përgjegjshëm. Nuk keni dorëzuar dëshmi te mjaftueshme, siç është përshkruar ne nenin 69 te LPP, qe tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale te kapacitetit teknik/profesional te saktësuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin e kontratës, andaj ne rethana të nuk kemi te bejmë me kurrfarë diskriminimi dhe me as shkelje te Nenit 7 te LPP-se siq pretendon ankuesi.Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave te dhëna ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderit. Kurse ju si OE me kohë jeni të njoftuar se jeni eliminuar për shkak te arsyeve ne vijim Kërkesa: 2.Operatori ekonomik ose Grupi i Operatoreve Ekonomik pjesëmarrës, është i obliguar me oferte te dorëzojnë Mostër për artikujt 9, 23, 24, 25, 26, 29, 30, 32, 33, 34, 35, 37, 38, 39, 40, 59, 60, 61, 63. 80, 109 dhe 131. Dëshmitë: 2. Mostrat për artikujt 9, 23, 24, 25, 26, 29, 30, 32, 33, 34, 35, 37, 38, 39, 40, 59, 60, 61, 63, 80,109 dhe 131, duhet te dorëzohen paraprakisht ne një paketim te mbyllur me shënimet e kompanisë ofertuese, para afatit te fundit për dorëzim te tenderëve. Ju ne tenderin e juaj, nuk keni ofruar mostrat sipas kërkesave dhe specifikave teknike te AK-se asnjë nga mostrat për artikujt e kërkuar te ofruara nga ana e juaj nuk përmbajnë mbishkrimet as logon sipas specifikave teknike te kërkuara nga AK në Njoftim për Kontrate dhe Dosje te Tenderit, dhe gjithashtu për artikullin nr. 26 nuk keni ofruar fare mostër. Kurse sa i përket pretendimit tuaj sa i përket printimit te logos ne mostra se nuk ka qene kërkesë ne dokumentin e tenderit sepse sipas jush ne nuk keni pranuar kurrfarë dizajni nga AK. Ky konstatim dhe pretendim të juaji nuk qëndron sepse AK ne listën e çmimeve i ka vendosur artikujt te cilët duhen te dorëzohen dhe disa prej tyre duhet te kenë Logon ose mbishkrimin e MPB-se, gjithashtu gjate kohës se sqarimeve te dosjes se tenderit, fare nuk keni bere një kërkesë për dizajn apo logo te MPB-se për artikujt e cekur.(Këta artikujt janë te

vendosur ne një tabelë ne kuadër te përgjigjes se kërkesës për rishqyrtim). Komisioni i vlerësimit me rastin e vlerësimit te ofertave i ka hapur kutitë e mostrave te mbyllura ne prezence te gjithë anëtarëve prezent dhe me rastin e kontrollimit, ekzaminimit te mostrave, është konstatuar për artikullin nr. 26 nuk keni ofruar fare moster, prandaj, nga arsyet e cekura me larte, oferta juaj Është refuzuar e pa përgjegjshëm.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 10.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 10/24, ndërsa me datë 13.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 24/10 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

3. Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/10, Lidhur me pretendimet e OE “Europrint Group Sh.P.K ka vlerësuar si në vijim:

Eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar pretendimet ankimor të OE ankues, përkatësisht arsyet eliminimit të tij/saj nga AK si dhe pretendimet tjera ankimore të Ankuesit. Duk sqaruar si në vijim: Sa i përket arsyes se eliminimit të Ankesit, sipas AK-se “OE ankues për artikullin nr. 26 nuk ka ofruar fare mostër”, ndërsa OE ankues pretendon se “AK tërheqjen e mostrës na kane bërë me tendencë vetëm e vetëm për te na eliminuar” lidhur me këtë pretendim ankimor Eksperti shqyrtues sqaron se: bazuar në autorizime e dhënë nga OSHP, kam kërkuar takim në AK-MPB përkatësisht me zyrën e prokurimit, për qasje në Mostrat e Tenderit. AK-MPB ka prezantuar Mostrat e Tenderit të dorëzuara nga Operatorët Ekonomik respektivisht mostrat e dorëzuara nga OE ankues për këtë aktivitet të prokurimit. Gjatë prezantimit të mostrave të tenderit të dorëzuar nga OE ankues, ndër të tjera, AK ka deklaruar se, “mostra për artikullin nr. 26 mungon”, dhe sipas AK-së “mostra për artikullin nr. 26 nuk ka qenë e përfshirë fare në paketimin e dorëzuar nga OE ankues”. Gjithashtu, ZPP ka deklaruar se, “në kohën kur janë hapur mostrat e tenderit, edhe unë si ZPP kam qenë i pranishëm bashkë me komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, dhe gjatë vlerësimit të mostrave, mostra për artikullin nr. 26 ka munguar, dhe nuk qëndron pretendimi i OE ankues për tërheqjen e mostrës nga AK për artikullin nr. 26”. AK ka deklaruar se “arsyet e eliminimit të OE ankues kanë qenë për shkak se asnjë nga mostrat për artikujt e kërkuar të ofruar nga OE ankues nuk përmbajnë mbishkrimet dhe as logon sipas specifikave të kërkuara nga AK në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes se Tenderit, si dhe gjatë vlerësimit të tenderit mostra për artikullin nr. 26 ka munguar dhe nuk ka qenë e përfshirë fare në paketimin e dorëzuar nga OE ankues”. Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e lartë cekura, sa i përket këtij pretendimi ankimor të OE ankues për “tërheqjen e mostrës nga AK me tendence vetëm e vetëm për te na eliminuar”, konsideron se, konstatimi dhe argumentimi i këtij pretendimi ankimor është përtej mundësive dhe kapaciteteve të Ekspertit shqyrtues, megjithatë, kurdo që OE ka dyshime të bazuara lidhur me këtë çështje, mund ti drejtohet organeve kompetente.”

Sa i përket arsyes tjetër të eliminimit të OE ankues, sipas AK-së “asnjë nga mostrat për artikujt e kërkuar të ofruar nga OE ankues nuk përmbajnë mbishkrimet dhe as logon sipas specifikave të kërkuara nga AK në Njoftim për Kontratë dhe Dosjes se Tenderit”, ndërsa OE ankues pretendon

se “printimit të logos në mostra nuk ka qene kërkesë në dokumentin e tenderit sepse në nuk kemi marrë kurrfarë dizajni nga Autoriteti Kontraktues”. Eksperti shqyrtues sqaron si në vijim: AK gjatë hartimit të dosjes së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, përveç tjerash, në kërkesat e vendosura në DT dhe në NJ. K. (Kërkesat dhe Dëshmitë), konkretisht të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale neni 9.1 & 9.2, ka përcaktuar kërkesat (dokumentet) për Operatorët Ekonomik, si më poshtë: Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale: 2. Operatori ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, është i obliguar me ofertë të dorëzojnë Mostër për artikujt 9, 23, 24, 25, 26, 29, 30, 32, 33, 34, 35, 37, 38, 39, 40, 59, 60, 61, 63, 80, 109 dhe 131. Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2. Mostrat për artikujt 9, 23, 24, 25, 26, 29, 30, 32, 33, 34, 35, 37, 38, 39, 40, 59, 60, 61, 63, 80, 109 dhe 131, duhet të dorëzohen paraprakisht në një paketim të mbyllur me shënimet e kompanisë ofertuese, para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve. Eksperti Shqyrtues, sqaron se: Bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit, si dhe bazuar në Mostrat e Tenderit të dorëzuara nga OE ankues të cilat janë prezantuar nga AK, për artikujt: nr. 30, 32, 37, 38, 39, dhe 40, nuk janë dorëzuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit përkatësisht specifikacionit teknik të përcaktuar nga AK sepse nuk përmbajnë mbishkrimet dhe as logon sipas specifikave të kërkuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë, rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i pa bazuar. Dosja e Tenderit është dokumenti kryesor mbi bazën e të cilës ofertuesi përgatitë ofertën e tij, prandaj edhe oferta vlerësohet nga AK në bazë të kërkesave, kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në njoftim për kontratë. Eksperti shqyrtues, duke u bazuar në të gjeturat dhe sqarimet e lartpërmendura, po ashtu marrë parasysh shkresat e lëndës faktet dhe dëshmitë, si dhe duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit konsideroj se, AK ka bërë vlerësimin e tenderit në pajtim me paragrafin 4 të nenit 59 të LPP-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet me rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

Paneli shqyrtues, pas analizës së dokumentacionit dhe veprimeve të palëve, ka arritur në përfundimin se gjetjet dhe mendimi i ekspertit shqyrtues janë të pranueshme edhe panelin

shqyrtues, pa nevojë që të gjitha të dhënat të ripërsëriten në detaje. Kjo është për faktin se nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga ankuesi sipas parashtrësës së tij/saj, dokumentacioni i tërë dosjes së tenderit, sqarimet e ofruara/dhëna nga Autoriteti Kontraktues si iniciuese e këtij aktivitet përfshirë edhe provat tjera relevante, vërtetohet se ankuesi nuk ka ofertuar konformë kërkesave të specifikacionit teknik të dhëna në dokumentacionin e prokurimit, sepse bazuar në mostrat e tenderit, mostrat e OE “Europinty” për artikujt nr. 30, 32, 37, 38, 39, dhe 40, kanë mungesën e mbishkrimeve apo logot e kërkuara në DT dhe NJK, që rjedhimisht e bëjnë ankuesin të papërgjegjshëm për këtë aktivitet.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar shkurtimisht se të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor kurse nga ana tjetër Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

- Përfundim –

Paneli shqyrtues analizoi në kontekstin e përgjithshëm të këtij aktiviteti të gjitha pretendimet reciproke të palëve (Ankuesit dhe AK) dhe ato se çfarë përmban raporti i ekspertit, duke i analizuar me ndërgjegje dhe kujdes profesional dhe erdhi në përfundimin, sipas bindes së tij të pavarur se ankesa nuk mund të pranohet si e bazuar andaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. AK, gjatë zbatimit të dispozitave të LPP dhe legjislacionit dytësor gjithmonë duhet të bazohet edhe në qëllimin e tij të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1, që të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Ndonëse raporti i ekspertizës dhe rekomandimet që i përmban nuk përbejnë detyrim as për palët e as për OSHP-në, në çdo rast Panelet Shqyrtuese e vlerësojnë dhe analizojnë karakterin e tyre dokumentues, në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të një lënde dhe administrimit të provave.

Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe konform nenit 117 të LPP, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Kurse, lidhur me tarifën ankimore, është vendosur në kuptim të nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së, lidhur me nenin 118 të LPP



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - EUROPRINT GROUP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: